“MUHAMMEDI ËSHTË I DËRGUAR I ALL-LLAHUT” DHE MESELEJA ËSHTË E MBYLLUR!

“SHUMË MUSLIMANË KANË LËNË PAS DORE KUPTIMIN E THELLË TË FESË!”

MIRËSITË E SALAVATIT NDAJ PEJGAMBERIT (A.S)

UDHA ISLAME

Botim i Myftinisë Shkodër
E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative

Viti 18 - Nr. 10 (212), Tetor, 2020

www.myftinia-shkoder.org

MYFTINIASHKODER1990

“ME ‘ALLAHU EKBER’ NDËRTOJMË JETËN!”

Islami përhapet në mënyrë të natyrshme, me vullnetin e lirë të njerëzve, edhe në mesin e rinisë, sepse kjo është feja e All-llahut! Dhe këtë Dritë, Ai e përhap në mesin e njerëzve, më shumë se rrezet e këtij dielli që na ngroh sot, dhe që do të ngrohë njerëzimin, deri në ditën e fundit!

Lindja e Begatë e Hz. Muhammedit (a.s)

(12 Rebiu-evvel 1442 - 28 tetor 2020)

“MUHAMMEDI ËSHTË I DËRGUAR I ALL-LLAHUT” DHE MESELEJA ËSHTË E MBYLLUR!

Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

Në Kur’anin Famëlartë urdhëron: ‘Muhammedi është i dërguar i All-llahut’ dhe thotë: ‘Dhe mjafton All-llahu si Dëshmitar!’, për dërgesën tënde (o Muhammed)!. Si për të na thënë neve sot, (që përpëlitemi në realitete të çuditshme dhe shumë paradoksale, kur bahet fjalë për fenë): o muslimanë, qëndroni në besën e pejgamberit tuaj (a.s), sepse propagandat e atyre që ia kanë shitur shpirtin dikujt tjetër, Zotit të botëve; janë propaganda boshe dhe një kotësi e madhe, me të cilën, shpeshherë, nuk ia vlen as të merresh fare!

Siç ishin propaganda boshe dhe një kotësi e madhe ajo çfarë dëgjuan brezat e mëpërparshëm nga flamurtarët e shirkut dhe të islamofobisë! Dhe, siç është propagandë boshe dhe kotësi e madhe ajo çfarë do të dëgjojnë fëmijët tanë, nipërit tanë e ata që do të vijnë brez pas brezi, se kështu është historia!

‘Muhammedi është i dërguar i All-llahut’, thotë All-llahu i Madhëruar në Kuranin Famëlartë dhe meseleja është e mbyllur!

Në takimin e para pak ditëve, që pata me imamët e nderuar të myftinisë sonë, udhëzova që duke nisur nga kjo e xhuma, në të gjitha xhamitë tona të nisim një cikël të ri ligjëratash kushtuar dërgesës së Hz. Muhammedit (a.s) mëshirë për të gjitha krijesat. Edhe si një shenjë mirënjohjeje, respekti dhe përuljeje ndaj Zotit të gjithësisë, që na bëri pjesë të këtij ymeti të madh!

Kjo fé, të dashurit e mi, do të vazhdojë e kjo dritë do të përhapet dhe, ju jeni dëshmitarët më të mëdhenj të kësaj që them! Shikoni xhamitë sot! Jo në Shqipëri, në tokën e Islamit, por në mbarë botën! Edhe në ato vende ku, në mënyrë të përçudnuar ka propaganda të vazhdueshme kundër Islamit dhe muslimanëve! Islami përhapet në mënyrë të natyrshme, me vullnetin e lirë të njerëzve, edhe në mesin e rinisë, sepse kjo është feja e All-llahut! Dhe këtë Dritë, Ai e përhap në mesin e njerëzve, më shumë se rrezet e këtij dielli që na ngroh sot, dhe që do të ngrohë njerëzimin, deri në ditën e fundit!

Islami përhapet në mënyrë të natyrshme, me vullnetin e lirë të njerëzve, edhe në mesin e rinisë, sepse kjo është feja e All-llahut! Dhe këtë Dritë, Ai e përhap në mesin e njerëzve, më shumë se rrezet e këtij dielli që na ngroh sot, dhe që do të ngrohë njerëzimin, deri në ditën e fundit!

(Nga hytbeja e xhumasë, më 16 tetor 2020, në xhaminë e Parrucës)

“ME ‘ALLAHU EKBER’ NDËRTOJMË JETËN!”

Ditën e xhuma, më 30 tetor 2020, nga xhamia e Parrucës, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari , dha mesazhin e tij të kësaj jave, edhe në atmosferën e begatë të përkujtimit të Lindjes së Begatë të Hz. Muhammedit (a.s).

Në hytben e tij, Myftiu vuri theksin tek përpjekjet e pandershme që prej kohësh përpiqen të prishin imazhin e Islamit dhe muslimanëve, duke i mveshur atyre çfarë nuk ka lidhje me fenë dhe thelbin e saj.

“Allahu ekber nuk ndez zjarre, Allahu ekber nuk mund të jetë asnjëherë simbol i shkatërrimit dhe i djegies!

Dhe ne nuk duhet të pranojmë nga askush në botë që përpiqet të shëmtojë imazhin e kësaj dëshmie të shtrenjtë dhe të shenjtë, me të cilën vijmë në këtë botë, me të cilën jetojmë dhe me të cilën hapim rrugët drejt të ardhmes duke e ndërtuar jetën si mëkëmbës të Allahut!

Sot, në këtë ditë teksa natyrshëm dënojmë, siç kemi bërë në vazhdimësi krimet e shëmtuara në disa vende, nuk jemi ne ata që duhet ta ndjemë veten të fajësuar sa herë në një vend apo në një cep tjetër të botës dikush, një anonim që kryesisht vritet në vend dhe nuk tregohet se kush ishte, pse ishte dhe pse e bëri etj.; nuk kemi pse të kompleksohemi dhe të ndjehemi në faj, kur dikush vret këtu apo atje!

Dhe ne nuk duhet të pranojmë nga askush në botë që përpiqet të shëmtojë imazhin e kësaj dëshmie të shtrenjtë dhe të shenjtë, me të cilën vijmë në këtë botë, me të cilën jetojmë dhe me të cilën hapim rrugët drejt të ardhmes duke e ndërtuar jetën si mëkëmbës të Allahut!

Jo të dashurit e mi! Ymeti i 2 miliardëve e kusur, nuk mund të poshtërohet, as ai dhe as feja e tij, se diku në një cep të botës, një anonim duke thirrur ‘Allahu ekber’ ka bërë një vepër përçudnuese, një vepër kriminale, një vepër të dënueshme që e dënon Kuran, që e dënon Pejgamberi dhe që e dënon Islami!

Atëherë tema të tillë si ‘terrorizmi islamik’, ‘fondamentalizmi islamik’ a ‘ekstremizmi islamik’ ne nuk i pranojmë nga askush në botë dhe i kthejmë mbrapsht! Ia kthejmë sepse nuk i duam dhe nuk janë tonat!

Kush është ai që guxon sot, të na thotë se liri e fjalës është të tallesh me shenjtërinë e mbi 2 milardë njerëzve në botë?! Kjo është lajthitje, kjo është histeri dhe kjo është humbje e ekuilibrit mendor, intelektual, qytetërues dhe mungesë e theksuar e zhvillimit të vlerave të racës njerëzore! Është dekadencë morale dhe intelektuale, pas të cilës ne nuk shkojmë dhe të cilën nuk e pranojmë!” – tha ndër të tjera Myftiu.

RUAJE SHËNDETIN DHE MOS U BËJ BJERRADITËS!

Janë dy hadithe, që shumë prej nesh neglizhojmë thelbin e tyre, për të cilin, Resulull-llahu (a.s) na tërheq vëmendjen.

Hadithi i parë: “Përfito nga pesë gjëra, para pesë të tjerave: nga rinia jote para pleqërisë tënde, nga shëndeti yt para sëmundjes tënde, nga pasuria jote para varfërisë tënde, nga koha jote e lirë para angazhimit tënd dhe nga jeta jote, para vdekjes tënde!”.

Hadithi i dytë: “Janë dy mirësi, në shfrytëzimin e të cilave, shumë njerëz janë të humbur: shëndeti dhe koha e lirë!”.

Nëse vini re, dy hadithet tërheqin vëmendjen e njerëzve që të shftytëzojnë mirësitë e Zotit, para se ato të shkojnë. Rinia, shëndeti, pasuria, koha dhe jeta në tërësinë e saj, janë epiqendra e këtyre dy këshillave të shtrenjta!

Në veçanti shëndeti dhe koha!

Subhanallah, sa e sa detaje të shëndetit, që ndoshta nuk ia dimë vlerën, as e falënderojmë Zotin për to, as ia njohim peshën e tyre në trupin tonë, vetëm pas lëndimit a sprovës..!

Sa e sa lëndime, që nuk i japim rëndësinë e duhur në kohë, duke neglizhuar, deri në atë pikë sa, edhe po të japësh më pas krejt pasuritë e botës nuk e kthen më atë, që të ishte dhënë dhe nuk dite një herë të thuash për të: Elhamdulilah!

Nga ana tjetër, sa kohë e tretur dhe e shkuar dëm në jetën e njeriut, aq sa po të përpiqej secili për të riorganizuar kohën e tij, brenda ditës, javës a muajit, patjetër që do kishte tjetër prodhimtari dhe rezultate në jetën e secilit prej nesh!

Në kryeveprën e tij: “Vlera e kohës tek dijetarët”, i Përndrituri Shejkh Abdulfettah Ebu Gudda sjell në vëmendje të lexuesit me qindra shembuj nga jeta e korifejve të dijes dhe shkencës së 14 shekujve tanë islam, ku emëruesi i përbashkët dhe detaji kryesor i shkëlqimit të tyre është shfrytëzimi i kohës!

Ulu një ditë në vete, merr një laps e një letër dhe shkruaj krejt ato mirësi, me të cilat të ka zbukuruar Krijuesi yt dhe falënderoje me qindra herë për secilën prej tyre!

Pastaj kërkoji falje për ato qindra e mijëra mirësi të harruara, a të fshehura nga dija e ndjesia jote dhe lutu pambarimisht që All-llahu i Madhëruar ta bekojë jetën tënde duke të udhëzuar drejt përfitimit nga koha sa je i ri, sa ke forcë për të punuar e për të fituar nga hallalli, sa e ke shëndetin dhe sa ende nuk të ka trokitur Azraili në derë, sepse, kur ai vjen, nuk të merr leje!

Ruaje shëndetin, mos abuzo me çfarë të është lënë amanet nga Zoti yt! Jepi hakun trupit tënd, respekto moshën dhe mos i tejkalo ato kufij, që realisht duhen respektuar në raportet tona me shëndetin dhe kohën!

Imam Muhamed B. Sytari
Shkodër, 13 tetor 2020

DY SHESHET E RUSIT ME EMRAT E TË NDERUARVE: HAFIZ SABRI KOÇI DHE DOM SIMON JUBANI

Një falënderim i përzemërt për Këshillin e Bashkisë Shkodër, që në këto momente miratoi projektvendimin për emërtimin e dy shesheve të Rusit me emrat e të nderuarve: Hafiz Sabri Koçi dhe Dom Simon Jubani!

Nderimi i këtyre dy burrave të shquar të Shkodrës, në këtë atmosferë të 30 vjetorit të rihapjes së kishave dhe xhamive tona, është pa dyshim një mirënjohje e madhe për të gjithë të rinjtë dhe qytetarët shkodranë, që 30 vite më parë, u bënë pishtarë të rizgjimit dhe rimëkëmbjes së madhe të kombit!

Pa dyshim, vendosja e dy emrave të prijësve tanë të nderuar në dy sheshet e Rusit, do të rrezatojnë mirësi e paqe, frymën e harmonisë dhe bashkëjetesës ndërfetare, si dhe do të na frymëzojë përherë e më shumë për të respektuar shenjtëritë tona, për të rrugëtuar me Dritën e Zotit drejt dinjitetit të dëshmisë së qenies tonë si mëkëmbësit e Zotit mbi tokë!

Mirënjohje dhe përulje me lutje e nderime për Hafiz Sabri Koçin dhe Dom Simon Jubanin, të cilët kam pasur fatin t’i njoh nga afër dhe që i konsideroj si dy njerëz të zgjedhur të këtij qyteti të madh të vlerave të besimit dhe harmonisë!

Imam Muhamed B. Sytari
Myfti i Zonës Shkodër
Shkodër, më 30 tetor 2020



Poema Muhamedije

Kjo poemë e përkthyer 'nxitimthi' motivohet nga dëshira për të sjellë për lexuesin në shqip këto ditë të fillimit të muajit Rabia el-Aual, muajit të lindjes së Profetit të nderuar – paqja dhe bekimi qoftë mbi të – sado pak nga bereqeti i kësaj poeme.

Kjo poemë ka tetë shekuj që këndohet masivisht nga muslimanët në të tërë botën. Autori i saj, Imam Sharafudin el-Busiri, me origjinë berbere nga Maroku, i lindur në Egjipt, në vitin 1212 është autori i poemave Burda, Hamzija, dhe Mudarija – të cilat së bashku me këtë poemë (Muhamedija) – janë ndër poemat më të njohura në traditën islame të poezive devocionale shkruar për Profetin – paqja dhe bekimi i Zotit qoftë mbi të.

Kjo është më e shkurtëra e këtyre poemave. Çdo varg fillon me përmendjen e emrit të Profetit, i Lavdëruari (Muhamed), dhe reflekton një nga vargjet e poemës, ku autori thotë se "shpirtërat ringjallen nga përmendja e tij".

Së fundmi, ky përkthim i kësaj poeme shpreson të shërbejë si ujitje për zemrat, ku të lulëzojë dashuria për "hajër el-berije" – më të vyerin e krijesave të Zotit.

Besnik Sinani

Muhamedi – më i fismi i Arabëve dhe popujve të tjerë në botë

Muhamedi – më i vyeri i atyre që kanë ecur në këtë tokë

Muhamedi – dhënësi zemërgjerë i gjithë mirësisë

Muhamedi – zotëria i përsosjes dhe bujarisë

Muhamedi – kurora e lajmëtarëve hyjnorë pa përjashtim

Muhamedi – i fjalës së mbajtur dhe vërtetësisë

Muhamedi – shtylla mbrojtëse e besëlidhjes

Muhamedi – i cilësive më të larta të përsosjes

Muhamedi – prej drite thelbi i tij ujitur

Muhamedi – dritë prej përjetësisë ende ndritur

Muhamedi – gjykues me drejtësi, zotëri i fisnikërisë

Muhamedi – burim dëlirësie dhe i urtësisë

Muhamedi – më i vyeri i krijesave të Zotit, ardhur nga Mudari

Muhamedi – më i vyeri i profetëve të Zotit në tërësi

Muhamedi – lajmi i tij është i vërtetë, atë pasojmë ne

Muhamedi – përjetësues i së vërtetës, shëmbëlltyrë eminente

Muhamedi – shpirtrat ringjallen nga përmendja e tij

Muhamedi – gjithë kombeve u obligohet lavdërimi i tij

Muhamedi – ornamenti i botës e shkëlqimi i tij

Muhamedi – hapësi i perdeve që ndriçon mbi errësirën e pikëllimin

Muhamedi – zotëria i mirësisë dhe virtytit

Muhamedi – formësuar prej bujaris së të Mëshirshmit, Krijuesit

Muhamedi – paria e krijesave të Zotit e i zgjedhuri

Muhamedi – i çiltër përtej çdo mëdyeshsi

Muhamedi – buzëqeshja nderuesve e mysafirëve

Muhamedi – mbështetësi bujar i fqinjëve

Muhamedi – universi u ndriçua prej ardhjes së tij

Muhamedi – shenjë hyjnore e Urtësisë së Krijuesit

Muhamedi – ndërmjetësi i njerëzimit ditën e ringjalljes

Muhamedi – drita udhëzuese në mes errësirës

Muhamedi – i dedikuar ndaj Zotit, zotëria i aspiratave të larta

Muhamedi – Vula e Lajmëtarëve të Zotit dhe Profetësisë.

(www.e-zani.com)

MIRËSITË E SALAVATIT NDAJ PEJGAMBERIT (A.S)

Naim Drijaj,
Imam - xhamia e Parrucës

Allahu i Madhëruar thotë: "Vërtet, Allahu e bekon të Dërguarin dhe melekët e Tij luten për të. O besimtarë, lutuni për të dhe përshëndeteni me "selam".[1]

Buhariu transmeton se Ebu El-Alijeh ka thënë se salavati i Allahut për të Dërguarin e Tij do të thotë se Allahu e lavdëron atë para melekëve. Ndërsa salavati i melekëve është lutje (dua) që ata i drejtojnë Allahut për Profetin (a.s).[2]

Ibn Kethiri ka thënë: "Nga ky ajet kuptojmë se Allahu (xh.sh) i informon robërit e Tij për pozitën e lartë që ka Pejgamberi (a.s) në qiell, për të luten melekët, gjithashtu Allahu (xh.sh) i urdhëron edhe njerëzit që të dërgojnë salavate dhe selame për Pejgamberin (a.s). Në këtë mënyrë bashkohen lëvdatat e banorëve të qiellit me ata të tokës".

Gjithashtu nga ky ajet kuptojmë: Nëse Allahu e lavdëron Pejgamberin (a.s) dhe melekët luten për të, atëherë edhe ne duhet t'i dërgojmë sa më shumë salavete atij, sepse ne kemi përfituar shumë të mira nga shpallja dhe dërgimi i tij në këtë botë po ashtu do të fitojmë edhe në botën tjetër.

Ne, përmes mësimeve të Pejgamberit (a.s), jemi ngritur nga injoranca në dituri, nga devijimi në udhëzim, nga prapambetja në përparim. Prandaj duhet të jemi mirënjohës ndaj Pejgamberit (a.s) dhe të dërgojmë sa më shumë salavate për të.

Çfarë përfitojmë duke dërguar salavate për Pejgamberin (a.s)?

Duke dërguar salavate për Pejgamberin (a.s) ne përfitojmë shumë mirësi ku disa prej tyre janë:

1. Duke dërguar salavate mbi Pejgamberin (a.s) ne zbatojmë urdhrin e Allahut (xh.sh).

2. Kur ne dërgojmë salavate mbi Profetin (a.s) lirohemi nga një ves i keq, i cili është koprracia. Ai që dërgon shumë salavate për Pejgamberin (a.s) tek Allahu (xh.sh) konsiderohet si njeri bujar. Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Koprrac i vërtetë është ai, i cili e dëgjon emrin tim dhe nuk bie salavat për mua".[3]

3. Salavatet për Pejgamberin (a.s) janë shkak për të fituar shumë shpërblime. Ebu Hurejrah (r.a) tregon, se i Dërguari i Allahut ka thënë: "Kush çon një salavat për mua, Allahu e mëshiron dhjetë here atë".[4] Enes ibn Malik transmeton se Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Nëse përmendem në prezencë të dikujt, ai le të bjerë salavat për mua, sepse kush bie një herë salavat për mua, Allahu e mëshiron 10 herë".[5]

Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Kushdo prej ymetit tim, i cili bie salavat për mua me sinqeritet nga zemra, Allahu e mëshiron 10 herë, e lartëson 10 gradë, i shkruan 10 sevape dhe i fshin 10 gjynahe".[6] Ne kemi përfituar nga mësimet e Pejgamberit (a.s) kur ai ishte gjallë dhe përsëri po përfitojmë edhe pse ai është i vdekur.

4. Kthimi i salavatit prej Pejgamberit (a.s) nga vendi ku Allahu (xh.sh) ia ka caktuar atij. Ibn Mes'udi (r.a) tregon, se i Dërguari i Allahut ka thënë: "Allahu ka melekë shëtitës, të cilët më përcjellin selamet e ymetit tim".[7] "Salavatet që ju dërgoni më shfaqen mua".[8] "Nuk ka asnjë musliman që më përshëndetë me selam e që Allahu të mos ma kthejë shpirtin për t'ia kthyer selamin".[9] Mjafton për njeriun që të jetë krenar kur i përmendet emri i tij për mirë para të dërguarit të Allahut paqja dhe nderimi i Allahut qoftë mbi të.

5. Afërsia me Pejgamberin (a.s). I Dërguari i Allahut ka thënë: "Njeriu më i afërt me mua në ditën e Kijametit është ai, i cili më ka dërguar më shumë salavate".[10]

6. Salavati është shkak për faljen e gjynaheve dhe largimin e brengave.

Transmetohet se Ubej ibn Keab (Allahu qoftë i kënaqur me të!) i ka thënë Pejgamberit (a.s): O i Dërguar i Allahut, sa të shpeshta duhet të jenë salavatet e mia ndaj teje? Sepse unë dërgoj shumë salavate për ju. Aq sa dëshiron, tha Profeti. Nëse ndaj një të katërtën e lutjeve për salavate, a është e mjaftueshme? tha Ubeji. Ndaj aq sa të duash tha Profeti, por nëse ndan kohë më shumë për salavate është më mirë për ty. Atëherë Ubeji tha nëse ndaj gjysmën e lutjeve për salavate, a është e mjaftueshme?. Bëj sa të duash, por nëse shton më shumë është më mirë për ty. Ubej ibn Keabi thotë: Unë përsëri i thashë Profetit (a.s) por nëse ndaj dy të tretat e lutjeve për salavate, a është e mjaftueshme? Ndaj aq sa të duash më tha, por nëse shton më shumë është më mirë për ty. Atëherë i thashë por nëse ndaj tërë kohën e lutjeve për salavate? Atëherë Pejgamberi (a.s) më tha: O Ubej nëse vepron kështu Allahu ti largon të gjitha brengat dhe ti falë gjynahet".[11]

Salavatet ndikojnë që në zemër të besimtarit të shtohet dashuria ndaj të Dërguarit të Allahut.

1. Kur'ani, El-Ahzab: 56.
2. Tefsir Ibn Kethir, 12/6578.
3. Nesaiu në Kubra, Hakimi dhe Tirmidhiu.
4. Muslimi.
5. Nesaiu në Kubra, Ibn Hibani, Ahmedi.
6. Nesaiu në Kubra dhe Taberaniu në El-Kebir.
7. Nesaiu në Muxhteba, Ibn Hibani dhe Ahmedi.
8. Silsiletu Sahiha.
9. Ahmed në Musned dhe Ebu Davud në Menasik.
10. Tirmidhiu.
11. Tirmidhiu.

INTERVISTE ME MENDIMTARIN E SHQUAR ISLAM NGA DAMASKU, DR. SALAHUDIN KEFTARO

Arben Halluni: *I nderuari doktor, normalisht çdo teleshikues që na ndjek në këto momente, në këtë emision, i shkon mendja për situatën në Siri, cila do te ishte ajo qe ju e përshkruani, situatë aktuale në Shamin Sherif, a mendoni ju si një mendimtar apo opinionist se, ky vend i cili njihet si vendi i civilizimit, i kulturës, i besimeve të ndryshme, do të gjejë një ditë paqen dhe qetësinë siç e gëzojnë popujt e tjerë në këtë jetë të përkohshme?*

Dr. Salahudin Keftaro: Me emrin e Allahut Mëshiruesit, Mëshirëbërësit, falënderimi i plotë i qoftë Zotit, paqja dhe shpëtimi qoftë mbi të gjithë profetët e Zotit dhe mbi Pejgamberin tonë (a.s).

Ju falënderoj për ftesën tuaj në këtë emision. Gjendja në Siri në fakt bën që të qajnë zemrat para se të qajnë sytë. Unë besoj se Siria është përballë një komploti të madh!

Sepse Siria përpara luftës ka jetuar në një bashkëjetesë shumë të mirë mes myslimanëve dhe të krishterëve, dhe për arsye sepse ajo përfaqëson dhe simbolizon qytetërime të ndryshme.

Islami në këtë vend është një islam i mesatar, dhe kjo falë dijetarëve dhe shkollave të saj të ndritura islame. Por, unë do të kthehem edhe njëherë të flas për disa shkaqe të asaj që ka ndodhur në Siri. Çfarë kanë thënë disa njerëz me pushtet në vitet 90? Ata janë duke përgatitur për një katastrofë të madhe në Lindjen e Mesme, dhe kjo anarshi, e cila djegë çdo gjë që i del para ka filluar në Siri!

Për fat të keq, në Siri kanë hyrë grupe të ndryshme të armatosura, që nuk janë nga Siria, dhe fatkeqësia më e madhe është, se disa prej nesh janë përfshirë në këtë situatë, dhe kemi mbërritur në një përfundim shumë të dhimbshëm.

Tani për momentin, ne po dalim nga kjo krizë në mënyrë graduale, ku lufta ka mbaruar, por tani ne po vuajmë nga një krizë shoqërore, ku e lus Allahun (xh.sh) që të kthehemi edhe njëherë siç ishim dikur, një familje e vetme, larg grupacioneve, duke lartësuar flamurin e mesatarizmit, në mënyrë që të përhapim dhe te shijojmë dashurinë njerëzore dhe paqen mes njëri-tjetrit.

Arben Halluni: *Duke vazhduar më tej i nderuar doktor në lidhje me këtë tematikë që i kushtohet edhe 30 vjetorit të rihapjes së besimit tonë, por edhe Mevludi Sherif, dhe duke u bazuar në këtë, do të kishim dëshirë të na jepni disa mesazhe në lidhje me përkujtimin e begatë të lindjes së Pejgamberi (a.s), dhe cilat do te ishin disa nga dobitë, që ne mund të përfitojmë, besimtarët sidomos në këtë kohë aktuale?*

Tani për momentin, ne po dalim nga kjo krizë në mënyrë graduale, ku lufta ka mbaruar, por tani ne po vuajmë nga një krizë shoqërore, ku e lus Allahun (xh.sh) që të kthehemi edhe njëherë siç ishim dikur, një familje e vetme, larg grupacioneve, duke lartësuar flamurin e mesatarizmit, në mënyrë që të përhapim dhe te shijojmë dashurinë njerëzore dhe paqen mes njëri-tjetrit.

Dr. Salahudin Keftaro: Ne kur përkujtojmë lindjen e Pejgamberit (a.s), ne nuk përkujtojmë lindjen e tij në aspektin fizik, por në fakt në përkujtojmë ato parime dhe mesazhe, të cilat ne duhet t'ia përcjellim të tjerëve përmes Shpalljes së tij. Ky Pejgamber i madh, i cili arriti t'i transformojë arabët, duke i nxjerrë nga injoranca në dituri, nga mllefi dhe urrejtja në dashuri dhe vëllazëri në mesin e tyre.

Unë do të ndalem në disa simbolika të këtij mesazhi, p.sh Pejgamberi (a.s) ka theksuar se: "Nuk ka prej meje përveç se nxënës ose mësues", pra ose nxënës i dijes ose mësues i dijes!

Ndërsa në një hadith tjetër, Pejgamberi (a.s) thekson se: "Nëse është duke ndodhur kiameti, pra fundi i botës, dhe ndonjëri prej jush mban në dorën e tij një filiz, le ta mbjell atë", ndërsa në një hadith tjetër thotë: "I gjithë njerëzimi është pjesëtarë i familjes se Allahut".

E në një hadith tjetër thotë: "Me i dashuri i njerëzve tek Allahu është ai njeri i cili është më i dobishëm për njerëzimin dhe për krijesat e Tij".

Njëherë një djalosh i ri shkoi tek Pejgamberi (a.s) dhe i tha: O i dërguar i Allahut, unë dëshiroj të shkoj në xhihad por nuk kam mundësi, (duke pasur parasysh se xhihadi në fenë tonë nuk është, përveç se për të mbrojtur fenë dhe atdheun), por ky djalosh nuk zotëronte asgjë prej mjeteve të luftës. Pejgamberi (a.s) buzëqeshi dhe i tha: "A e ke nënën gjallë"? I tha: Po! Atëherë Pejgamberi (a.s) i tha: "Shko dhe qëndroi afër nënës tënde, sepse aty e ke xhenetin". Prandaj këto janë arsyet që ne e duam dhe përmallohemi për këtë profet të nderuar.

Sot, ndeshim dhe dëgjojmë thirrje dhe propaganda të ndryshme, të cilat përpiqen të lëndojnë dhe ofendojnë personalitetin e Pejgamberit (a.s) dhe ndoshta deri diku nganjëherë i justifikoj veprimet e këtyre njerëzve, sepse shumica e tyre e kanë keqkuptuar figurën e Pejgamberit tonë (a.s) dhe konceptin e fesë. Madje edhe vete Pejgamberi (a.s) kur u rëndua gjendja e tij, ndërsa po thërriste në rrugën e Allahut banorët e qytetit Taif, (qytet i vogël afër Mekës), ai nuk ua ktheu me të ashpër, as nuk u hakmor ndaj tyre, por tha duke iu lutur Zotit: "O Zoti im, udhëzoje popullin tim, sepse ata nuk e dinë se çfarë po veprojnë!".

Prandaj, duke marr shkas nga kjo ndodhi, vëmë re se ne myslimanët kemi

Nuk mund të gjykosh Islamin nëpërmjet gjendjes së myslimanëve sot. Ne duhet të vendosim një plan, ose program nëpërmjet të cilit njerëzit të njohin Islamin, dhe popujt perëndimor janë popuj të cilët e kërkojnë të vërtetën, e nëse shohim sot që ata sillen keq ndaj diçkaje, është si pasojë e keqkuptimit të tyre dhe mos dijes së tyre për të vërtetën.

neglizhuar në përcjelljen e mesazhit të vërtetë të Islamit, për t'i mundësuar popujve në perëndim që ta kuptojnë se çfarë është Islami në të vërtetë.

Sikur ata ta njihnin siç duhet Islamin e vërtetë, bukurinë e tij, paqen dhe dashurinë reciproke që posedon ai do ta kishin nderuar dhe respektuar, pa dyshim!

Por sigurisht që ne i kritikojmë edhe disa individë në perëndim, të cilët fyejnë dhe lëndojnë simbolikat dhe shenjtërit e fesë sonë me pretekstin e lirisë së shprehjes. Unë për vete kam mësuar që në fëmijërinë time, se liria ime mbaron aty ku unë lëndoj dinjitetin e tjetrit!

Ndoshta shumë prej këtyre njerëzve nuk e dinë se kush është ky Pejgamber në të vërtetë, nuk e kuptojnë as brenda familjeve të tyre, dhe kjo sjell si pasojë një përplasje të qytetërimeve.

Unë nuk bëj thirrje për dialog të qytetërimeve, por për vëllazërim të qytetërimeve, sepse të gjithë ne jetojmë në këtë tokë si një familje e vetme, dhe Allahu i Madhëruar thotë në Kur'anin Famëlartë: "O ju njerëz, Ne ju kemi krijuar nga një mashkull dhe një femër dhe ju kemi bërë fise dhe popuj, në mënyre që të njiheni mes vete".

Duke u bazuar në këtë ajet kur'anor për ne ka qenë një obligim, që të njihemi dhe afrohemi me njeri-tjetrin, si qytetërim islam dhe si qytetërim perëndimor, dhe që të qëndrojmë së bashku në një tryeze të vetme me dashurinë e dialogut, dhe të vendosim pikat mbi shkronja, e atëherë kur ata ta njohin fenë tonë siç e njohim ne, dhe kur ne t'i njohim ata siç janë ata në të vërtetë, atëherë me siguri secili prej nesh do të tregoje dashuri dhe respekt për tjetrin, sepse njeriu është vëlla i njeriut.

Arben Halluni: *Doktor, ju e përmendët një element shume interesant, që është një mangësi e ymetit ose e myslimanëve në përgjithësi në mbarë botën, ajo që nuk është bërë si duhet thirrja në mënyrën më të urtë, kuptohet, për figurën dhe personalitetin e Pejgamberit (a.s) dhe e them me keqardhje që duhet ndoshta të ndodhë diçka, siç është edhe rasti i cili edhe ju e përmendët më parë, ku ofendohet një njeri i cili respektohet nga myslimanët dhe jomyslimanët për të qenë jo vetëm ymeti islam i bashkuar por edhe të tjerët, për t'u njohur me jetën dhe figurën e Pejgamberit (a.s), pra ndoshta është ajo që ne si myslimanë, ndoshta duhet të punojmë më tepër për t'i njohur njerëzit me figurën e Pejgamberit (a.s).*

Dr. Salahudin Keftaro: Unë e them gjithmonë që momentalisht topi është në fushën tonë, ne në fakt kemi neglizhuar shumë në këtë aspekt, në radhë të parë si thirrësa në islam, por gjithashtu edhe dijetarët tanë, por edhe myslimanët e thjeshtë në përgjithësi. Sepse nuk mund të gjykosh Islamin nëpërmjet gjendjes së myslimanëve sot. Ne duhet të vendosim një plan, ose program nëpërmjet të cilit njerëzit të njohin Islamin, dhe popujt perëndimor janë popuj të cilët e kërkojnë të vërtetën, e nëse shohim sot që ata sillen keq ndaj diçkaje, është si pasojë e keqkuptimit të tyre dhe mos dijes së tyre për të vërtetën.

Ne kemi një eksperiencë të mirë në Siri, ku ne jetojmë me vëllezërit tanë të krishterë duke shkuar shumë mirë me njeri-tjetrin, dhe këtë gjë nuk e kemi shpikur ne, por në realitet është në thelbin e fesë sonë, dhe nga dashuria për atdheun tonë. A nuk i urdhëroi Pejgamberi (a.s) shokët e tij që po persekutoheshin në Mekë për fenë e tyre, a nuk i urdhëroi që të shkonin në Abisini (Etiopia e sotme), ku atje sundonte një mbret i krishterë, i cili nuk i bënte padrejtësi askujt? A nuk i priti Pejgamberi (a.s) priftërinjtë që vinin nga Nexhrani në xhaminë e tij, ku ua hapi xhaminë në mënyrë që ata të faleshin dhe të luteshin sipas mënyrës dhe traditës së tyre!?

Do të sjell një shembull për një ngjarje të ngjashme, që ka ndodhur në Danimarkë, ku nëpërmjet disa karikaturave ofendohej figura e Pejgamberit (a.s). Atëkohë, unë i kam ftuar në Siri, në xhaminë dhe kompleksin tonë "Shejkh Ahmed Keftaro" për vizitë ata persona, të cilët i bënë këto karikatura fyese, të vinin me shpenzimet tona, por ata e refuzuan ftesën.

Pas kësaj ftese që bëra, ne na vizitoi ministri i punëve të jashtme i Danimarkës, dhe së bashku me të erdhën edhe disa priftërinj nga Danimarka. I gjithë ky veprim ishte si pasojë e asaj, që na ka mësuar hoxha jonë, Shejkh Ahmed Keftaro, Allahu e mëshiroftë! Të pasojmë me urtësi, me politikë fetare dhe me mënyrën e komunikimit më të mirë. A nuk ka thënë Zoti ynë në Kur'anin Famëlartë: "Dhe thirr në rrugën e Zotit tënd me urtësinë dhe këshillë të mirë dhe debato me ta me mënyrën më të mirë!"?

Atëherë ata do ta kuptojnë, se jemi me ta dhe se ne marrim pjesë duke kontribuar në ndërtimin e kësaj shoqërie njerëzore.

Arben Halluni: *Doktor, në kuadër të vlerave që ju përmendët në këtë bashkëbisedim të këndshëm unë kam lexuar disa thënie tuajat, ndër to është: "Duajeni njeri-tjetrin sa të jeni gjallë, sepse malli pas vdekjes nuk ka vlerë", dhe tjetra është: "Fshije gabimin që të vazhdojë vëllazëria dhe mos e fshij vëllazërinë për një gabim". Cili do të ishte një koment tjetër i juaji për sa i përket bashkëjetesës në mes të besimeve të ndryshme?*

Dr. Salahudin Keftaro: Ne kemi një eksperiencë të mirë në Siri, ku ne jetojmë me vëllezërit tanë të krishterë duke shkuar shumë mirë me njeri-tjetrin, dhe këtë gjë nuk e kemi shpikur ne, por në realitet është në thelbin e fesë sonë, dhe nga dashuria për atdheun tonë. A nuk i urdhëroi Pejgamberi (a.s) shokët e tij që po persekutoheshin në Mekë për fenë e tyre, a nuk i urdhëroi që të shkonin në Abisini (Etiopia e sotme), ku atje sundonte një mbret i krishterë, i cili nuk i bënte padrejtësi askujt? A

nuk i priti Pejgamberi (a.s) priftërinjtë që vinin nga Nexhrani në xhaminë e tij, ku ua hapi xhaminë në mënyrë që ata të faleshin dhe të luteshin sipas mënyrës dhe traditës së tyre!?

Myslimanët sot duhet t'i përvetësojnë këto cilësi dhe mësime të arta që të jenë një mjet sigurie në shoqërinë e tyre, dhe te mos jenë një minë me sahat në mes të shoqërisë së tyre.

Ne i hapim krahët dhe zemrat tona për ata të cilët nuk janë myslimanë, dhe kjo nga ana tjetër na e shton më tepër respektin dhe dashurinë me njeri-tjetrin.

Duhet t'i mbjellim këto parime në mendjet dhe zemrat e rinisë sonë, në mënyrë që ne të jetojmë në atdheun tonë të sigurt dhe të lumtur, dhe kjo është detyrë parësore e njerëzve të fesë, dijetarëve dhe thirrësve, sepse ata supozohet që të jenë çelësat dhe udhëheqësit e së mirës, sepse ata janë të cilët i hapin të parët dyert e së mirës për njerëzit.

Arben Halluni: *Dr. Salahudin, është hera e dytë që ju vizitoni Shkodrën, një qytet që njihet si qyteti i kulturës, dijes, artit dhe i bashkëjetesës ndërfetare midis myslimanëve dhe të krishterëve, si e shikoni këtë vlerë të çmueshme që ka Shkodra?*

Dr. Salahudin Keftaro: Mua më ka nderuar Zoti duke më mundësuar që të vizitoj Shkodrën, që vitin e kaluar, dhe të kthehem për vizitë në Shkodër sot për herë të dytë. Jua them sinqerisht, pa e ekzagjeruar, që unë shpresoj që një ditë të jetoj në këtë vend, duke parë mirësitë e këtij qyteti, dhe urtësinë e dijetarëve dhe prijësve të saj, xhamitë e shumta që ndodhen në të dhe nga këtu unë shoh që Shkodra është një shembull i mirë në të gjithë Shqipërinë për këtë bashkëjetesë. Kjo më kthen në kujtimet e mia diku para dhjetë viteve ose më tepër, ku kujtoj myftiun e këtij qyteti, Imam Muhamed Sytarin kur studionte tek ne, në universitetin tonë. Jam i mendimit se myftiu i nderuar i këtij qyteti, i cili ka studiuar tek ne dhe ka parë mesatarizmin dhe bashkëjetesën mes nesh dhe e ka përcjell këtë mesatarizëm edhe më tepër këtu në vendin e tij, duke e përhapur me urtësi këtë mesatarizëm.

Kam takuar edhe kryetarin e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, dhe gjithashtu kam parë sesi prijësit myslimanë takohen dhe respektohen me prijësit e krishterë, mbi çështjet fetare dhe çështjet kombëtare. Prandaj duke u

Ne i hapim krahët dhe zemrat tona për ata të cilët nuk janë myslimanë, dhe kjo nga ana tjetër na e shton më tepër respektin dhe dashurinë me njeri-tjetrin.

Duhet t'i mbjellim këto parime në mendjet dhe zemrat e rinisë sonë, në mënyrë që ne të jetojmë në atdheun tonë të sigurt dhe të lumtur, dhe kjo është detyrë parësore e njerëzve të fesë, dijetarëve dhe thirrësve, sepse ata supozohet që të jenë çelësat dhe udhëheqësit e së mirës, sepse ata janë të cilët i hapin të parët dyert e së mirës për njerëzit.

nisur nga kjo unë kam dëshirë gjithnjë që ta përsëris vizitën time në Shkodër dhe në Shqipëri.

Arben Halluni: *I nderuar doktor, meqenëse jemi edhe në atmosferën e përkujtimit të 30 vjetorit të rilejimit të besimit fetar dhe të rihapjes së xhamisë së parë që është xhamia e Plumbit, që besoj se ju e keni vizituar, dhe ashtu siç ju e përmendët që bashkëjetesa këtu është e prekshme ashtu siç ka qenë edhe e prekshme rihapja e kulteve fetare në qytetin e Shkodrës, ku myslimanët kanë shkuar tek vëllezërit e tyre katolikë për të rihapur kishën ashtu edhe ata kanë ardhur tek vëllezërit e tyre myslimanë për të rihapur xhaminë, dhe besoj ju jeni në dijeni kur është rihapur besimi fetar para 30 viteve, si e keni pritur këtë ngjarje ju si popull i Sirisë dhe si komunitete fetare atje? Dhe cili do të ishte mendimi juaj, ose mesazhi juaj në lidhje me këtë përvjetor që ne kemi?*

Dr. Salahudin Keftaro: Shqipëria ka vuajtur ashtu sikurse kanë vuajtur popujt e tjerë të Evropës Lindore, dhe ne e dimë që feja ka qenë e ndaluar këtu në Shqipëri, si ajo islame ashtu edhe ajo e krishtere. U mbyllen kishat dhe xhamitë, dhe u persekutuan njerëzit dhe klerikët e fesë. Unë jam i mendimit së kësaj ideologjie sot i ka ikur koha dhe ka përfunduar dhe gjithsesi feja ngeli përsëri e lartësuar, dhe xhamitë mbeten përsëri duke thirrur "Allahu Ekber"!; edhe kishat iu rikthyen kambanave të tyre, dhe nga këtu do ishte dashur që ne të përcillnim mesazhin tonë, që kuptojeni fenë tuaj ashtu siç është në të vërtet feja!

Feja na fton të gjithëve drejt dashurisë, harmonisë, tolerancës, pajtimit dhe vëllazërisë, dhe të gjitha këto ne i kuptojmë nëpërmjet dijetarëve të Shkodrës dhe të mbarë Shqipërisë.

Kështu që feja juaj ka te drejtat e saj tek ju, ta dëgjoni me vëmendje atë prej trashëgimtarëve të Profetit (a.s), pra prej dijetarëve, dhe mendoj se Allahu i Madhëruar e ka dashur Shkodrën me këtë mentalitet mesatar. Patjetër ne duhet t'i kthehemi fesë dhe besimit tonë, që ta kuptojmë se çfarë është feja në të vërtetë... ajo është një sistem moral, një sistem adhurimesh ku secili bashkëpunon me tjetrin.

Arben Halluni: *Dhe, në përfundim të kësaj interviste, cili do të ishte mesazhi juaj për qytetarët e Shkodrës dhe përtej saj?*

Dr. Salahudin Keftaro: Mesazhi im për popullin shqiptar dhe veçanërisht atë të Shkodrës është që ata të jenë si një familje e vetme, myslimanët dhe të krishterët dhe të gjitha komunitetet e këtij vendi, dhe që të përpiqen dhe të punojnë shumë dhe të bashkëpunojnë me njeri-tjetrin, sepse sfidat janë me të vërtetë të mëdha, njëra prej tyre është varfëria, lëndët narkotike, injoranca, prandaj duhet të jemi të vëmendshëm, që të jemi patriotë të vendit tonë dhe besimtarë gjithashtu, në mënyrë që të përballemi me këto sfida me vendosmëri të lartë, në mënyrë që të ndërtohet atdheu dhe të lindin breza të mirë, të cilët respektojnë të moshuarit dhe mëshirojnë të vegjlit tanë.

I lutem Allahut (xh.sh), që ta nderojë këtë vend me më shumë siguri dhe paqe dhe të qëndrojmë në vizitat e njeri-tjetrit, dhe inshAllah ju presim në Damask, pasi të qetësohet situata atje, në Siri me zemër të ngrohtë dhe me mikpritje të mirë, inshallah!

(Bashkëbisedimin i teologut Arben Halluni me mendimtarin islam damasken, Dr. Salahudin Keftaro dhënë në Tv1-Channel dhe radio Jehona, më 30 tetor 2020)

NJË REAGIM NDAJ MACRON: E DI TI SE Ç'ËSHTË ISLAMI? MËSOJE Z.PRESIDENT, ËSHTË FEJA E ZOTIT!

Si reagim ndaj deklaratave të fundit islamofobe të presidentit francez Macron, Sekretari i Përgjithshëm i Unionit Botëror të Dijetarëve Myslimanë, Dr. Ali al-Kurre Dagi, shkroi sa më poshtë në mesazhin e tij drejtuar presidentit francez:

"Z. Macron, mos u shqetësoni për fenë tonë, Islamin, sepse Islami kurrë nuk është mbështetur te autoritetet ose ka ngritur shpatën e tij kundër kujtdo që refuzon ta pranojë atë në mënyrë që t'i imponojë flamurin e tij me forcë.

Islami është një e vërtetë e përjetshme, ekzistenciale që zgjidh probleme që janë të pazgjidhshme nga autoritetet.

Është feja e Allahut e jo një sistem qeverisje bazuar në gjendjen shpirtërore të elektoratit dhe falsifikimin e votave.

Islami është prania e vazhdueshme e arsyes, argumenteve dhe mbrojtja e jetës dhe dinjitetit të njeriut. Ku ka liri, Islami është i mirë, dhe ku ka dhunë dhe tirani, Islami po përhapet gjithnjë e më shumë, pavarësisht tiranëve .

Macron, besimi ynë nuk po kalon, dhe as nuk do të kalojë ndonjë krizë, sepse Islami nuk është një shpikje njerëzore që të kesh frikë nga mangësitë, dëmtimet dhe pasimet e dobëta. Ai është Islam dhe kjo është e mjaftueshme. Islami ekziston përkundër intrigave të të tjerëve dhe përkundër Islamofobisë.

Ne nuk kemi frikë për besimin tonë dhe as nuk është nevoja të kemi frikë, zoti President, për ata që flasin për ekzistencën e një krize.

Në vend të kësaj, ne ju themi: E ardhmja i përket Islamit! Ne kemi frikë vetëm për të ardhmen e atyre shoqërive që u janë nënshtruar feve të njerëzve... Kemi frikë për shoqëri të tilla me qeveri që varen nga krijimi i armiqve.

Na vjen keq për sundimtarin që nuk ndalet së jetuari krizë dhe që sheh luftërat fetare të Mesjetës, edhe pse jetojmë në shekullin e 21. Nëse ekziston një krizë e vërtetë, kjo është për shkak të standardeve të dyfishta të disa udhëheqësve politikë perëndimorë.

Ne duam t'ju kujtojmë se frenat e fuqisë dhe autoritetit në botën arabe dhe islame, në shumicën e vendeve, mbahen nga ata që krijuat ju, ose kryen grusht shteti, që morën bekimin tuaj për të ardhur në pushtet përmes kufomave të njerëzve të pafajshëm.

Presidenti Macron, ju jeni në një krizë të çoroditjes morale, njerëzore dhe politike dhe Islami nuk mund të mbajë përgjegjësinë, as të mbajë barrën e liderëve të rremë dhe kukullave që krijuan kriza me sponsorizimin tuaj".

Kleriku i lartë musliman mbyll mesazhin e tij ndaj Macron duke cituat një sure Kur'ani:

Macron: "Gjykimi i përket vetëm Allahut dhe Ai ka urdhëruar që ju ta adhuroni vetëm Atë. Është e vetmja fe e vërtetë, por shumica e njerëzve nuk e dinë ". (Jusuf, 40).

(www.tesheshi.com)

"Shkëndija e Islamit nuk mund të shuhet dhe drita e tij kurrë nuk mund të pengohet: "Allahu nuk pranon, vetëm se ta plotësojë dritën e Tij, edhe nëse jobesimtarët e urrejnë". Ai (Islami) në vetë natyrën e tij nxit për rimëkëmbje dhe rizgjim; nëse myslimanët flenë ndonjë ditë, atëherë patjetër Islami ka për t'i zgjuar!"

Dr. Jusuf El-Karadavi

MAROKU
OSE MBRETËRIA E MAROKUT

Mbretëria e Marokut, ose Maroku, ndodhet në skajin veriperëndimor të kontinentit të Afrikës, në rajonin e Magribit, dhe kufizohet me Algjerinë në lindje dhe në jug, gjithashtu në jug kufizohet edhe me Shkretëtirën Perëndimore, në veri kufizohet me Detin Mesdhe (ka një vijë bregdetare prej 468 km të gjatë), dhe në perëndim kufizohet me Oqeanin Atlantik (me një vijë bregdetare që i tejkalon 1000 km gjatësi).

Nga Evropa, Maroku ndahet vetëm nga ngushtica e Gjibraltarit.

Maroku gjithashtu pretendon esklavat Sebte (Ceuta), Melilla dhe gadishullin Kamíra (Peñón de Vélez de la Gomera), të gjitha nën juridiksionin Spanjoll, si dhe disa ishuj të vegjël të kontrolluar nga spanjollët në brigjet e vendit.

Kryeqyteti i Marokut është Rabat dhe qyteti më i madh i vendit është Kazablanka (Casablanca).[1]

Maroku shtrihet në një sipërfaqe prej 710,850 km2, ndërsa numri i popullsisë shkon në 37.045.665 banorë (worldmeter, Tetor, 2020).[2]

Emri Marok është vënë nga vendasit maroken Amazigë dhe është një shkurtim i emrit Marrakish, që në gjuhën Amazige do të thotë "Toka e Zotit".

Maroku aktualisht është vend anëtar i Lidhjes Arabe, anëtar i Organizatës Arabe të Magribit, anëtar i Organizatës së Konferencës Islamike, anëtar i Organizatës Ndërkombëtare të Frankofonisë, i Grupit të Dialogut Mesdhetar, anëtar i Grupit 77, gjithashtu është një aleat i madh jashtë NATO-s.[3]

FEJA

Islami është feja zyrtare e Marokut dhe muslimanët përbëjnë 99% të popullsisë së vendit, ku pothuajse të gjithë janë ndjekës të shkollës sunite Malikije. Mësimet islame rregullojnë jetën familjare dhe të komunitetit. Në Marok gjenden gjithashtu edhe të krishterë dhe hebrenj, të cilët përbëjnë më pak se 1% të popullsisë së përgjithshme.

GJUHA

Gjuha Arabe është gjuha zyrtare në Marok. Një numër i madh i berberëve dhe arabëve flasin gjithashtu frëngjisht, ose spanjisht.

Shumica e banorëve të maleve flasin ende gjuhën berbere-amazige, pasi izolimi në rajonet malore i ndihmon ata të ruajnë gjuhën dhe dialektet e tyre, gjuhë të cilën ata e harrojnë shpejt, menjëherë pas qëndrimit të tyre në qytete.

KLIMA

Klima e Marokut ndryshon sipas rajoneve. Vendi ka një klimë mesdhetare në veri, oqeanike në perëndim, dhe shkretinore në jug; zonat bregdetare të vendit karakterizohen nga klima e butë. Rajonet malore të jugut kanë një klimë të ftohtë dhe të lagësht gjatë sezonit të dimrit, ku malet Atlas që përqafojnë qytetin Marrakish, njohin reshje të mëdha dëbore. Temperatura mesatare në Marrakish gjatë muajit dhjetor, nuk i kalon 18 gradë. Gjysma veriore e vendit ka dy stinë: një stinë të thatë dhe të nxehtë që shtrihet nga muaji maj deri në fund të shtatorit, dhe një stinë të butë dhe të lagësht, që shtrihet nga fillimi i tetorit deri në fund të prillit.

EKONOMIA

Maroku ka burime të konsiderueshme minerale, pasi përmban rezerva të konsiderueshme hekuri, por edhe minerale të tjera, si bariti, plumbi, mangani, kobalti, bakri, zinku, antimoni (kohli) dhe fluori. Gjithashtu, Maroku është vendi i tretë në botë për prodhimin e fosfateve, dhe zë vendin e parë për eksportimin e tyre. Nga ana tjetër, burimet e energjisë janë shumë të kufizuara, pasi prodhimi vendas i antracitit dhe i gazit natyror, mezi mbulon 5% të nevojave, duke e detyruar Marokun të importojë.

Kulturat më të rëndësishme bujqësore që mbillen në vend janë gruri, elbi, misri, thjerrëzat, fasulet, agrumet, etj. Kultivimi i pemëve frutore në përgjithësi, dhe ulliri në veçanti, zënë një vend të rëndësishëm të ekonomisë.

Mbarështimi i bagëtive zë një vend të veçantë në sektorin e bujqësisë.

Sektori industrial kontribuon me rreth 28% të prodhimit të brendshëm bruto. Industria ushqimore është në krye, e ndjekur nga industria e tekstilit, lëkurës dhe ndërtimit.

HISTORI

Fenikasit themeluan kolonitë e tyre në perëndim të Afrikës Veriore, në bregdetin e saj, diku rreth shekullit të dymbëdhjetë para Krishtit. Romakët futën kultivimin e shegëve dhe rrushit në vend, si dhe industrinë e minierave. Pastaj, bashkë me pjesën tjetër të Afrikës Veriore, Maroku iu bashkëngjit sundimit romak, të cilët krijuan një mur që shtrihej nga qyteti i quajtur tani Rabat, e deri në qytetin e Taza. Nga viti 40 e.j, e deri në shekullin e 7-të, rajoni u sundua nga Romakët, Vandalët dhe Bizantinët, të cilët erdhën aty njëri pas tjetrit.

***

Historianët e lashtë, e kanë quajtur "Magrib" gjithë atë territor që shtrihej në perëndim të Egjiptit, dhe e ndanin në tre rajone kryesore. Marokut të sotëm, asokohe i takonte të shtrihej në rajonet Magribi i Mesëm dhe Magribi i Largët. Myslimanët fillimisht e morën Marokun në vitin 62 të hixhretit (viti 681) nën komandën e Ukbe ibn Nafi, por përfundimisht vendi u mor nga muslimanët nën udhëheqjen e komandantit Musa ibn Nusajr, në vitin 88 të hixhretit (viti 707), e më pas shumë berberë hynë në Islam.

Në vitin 172 të hixhretit (viti 788), udhëheqësi arab Idris ibn Abdullah, i bashkoi rajonet arabe dhe berbere nën sundimin e tij. Ai gjithashtu themeloi Shtetin e Idrisëve (një grup sundimtarësh nga e njëjta familje), që sundoi për gati 200 vjet, dhe sundimtarët e shtetit mbanin titullin 'sulltan'. Qyteti i Fes-it u zhvillua si kryeqyteti i Shtetit të Idrisëve, qytet i cili arriti të bëhej një qendër e madhe fetare dhe kulturore.[4]

Pas sundimit të Idrisëve, një seri dinastish myslimane marokene filluan të sundonin në Marok. Në shekullin e 16-të, monarkia Sa'adi, veçanërisht nën udhëheqjen e Ahmed El-Mansur (1578-1603), zmbrapsi pushtuesit e huaj dhe themeloi një epokë të artë. Dinastia Alauite, së cilës i përket familja aktuale mbretërore marokene, daton nga shekulli i 17-të.

Në vitin 1860, Spanja e pushtoi Marokun e Veriut dhe një rivalitet tregtar gjysmë shekullor filloi midis fuqive Evropiane, që e panë sovranitetin e Marokut të shkatërrohej në vazhdimësi.

Në vitin 1912, Francezët imponuan një protektorat mbi vendin. Lufta e zgjatur për pavarësinë nga Franca, përfundoi me sukses në vitin 1956. Qyteti i ndërkombëtarizuar i Tanxha-s (Tangier), dhe shumica e zotërimeve Spanjolle iu dorëzuan vendit të sapoçliruar po atë vit. Sulltani Muhammed V, gjyshi i monarkut aktual, e organizoi shtetin e ri si monarki kushtetuese dhe në vitin 1957 ai mori titullin mbret.

Xhamia Hasani II
Kazablanka, Marok

Që nga tërheqja e Spanjës (në vitin 1976) nga ajo që sot quhet Saharaja Perëndimore, Maroku e ka shtrirë kontrollin e vet administrativ në afërsisht 75% të këtij territori; megjithatë, OKB-ja nuk e njeh Marokun si fuqinë administruese të Saharasë Perëndimore. Që nga viti 1991, OKB-ja ka monitoruar një armëpushim midis Marokut dhe Frontit Polisario - një organizatë që mbron pavarësinë e territorit të Saharasë Perëndimore - dhe në dhjetor 2018, kanë rifilluar negociatat për statusin e territorit.

Mbreti Muhamed VI, në fillim të vitit 2011 iu përgjigj protestave prodemokracisë në rajon, duke zbatuar një program reforme që përfshinte një kushtetutë të re, miratuar nga referendumi popullor, në korrik 2011, nën të cilin disa kompetenca të reja ishin zgjeruar për parlamentin dhe kryeministrin, por autoriteti përfundimtar do të mbetej në duart e monarkut.

Në nëntor të vitit 2011, Partia për Drejtësi dhe Zhvillim - një parti e moderuar islame - fitoi numrin më të madh të vendeve në zgjedhjet parlamentare, duke u bërë partia e parë islame që drejton Qeverinë Marokene.[5]

UNIVERSITETI EL-KARAVIJJIN

Universiteti El-Karavijjin ndodhet në qytetin Fes, të Marokut. Sipas UNESCO-s. Bazuar në renditjen e Librit të Rekordeve Gines, ky universitet është institucioni më i vjetër i arsimit të lartë dhe universiteti i parë në botë që ka dhënë diplomë në mjekësi. Ky universitet vazhdon akoma edhe sot të funksionojë si i mirëfilltë dhe jep mësim deri më tani, pa ndërprerje. Historianët i referohen këtij universiteti si universiteti më i vjetër në botë.

Universiteti El-Karavijjin është një institucion arsimor, i varur nga Xhamia El-Karavijjin, e cila u ndërtua nga Fatime bint Muhammed El-Fihri El-Kurajshi, në vitin 245 të hixhretit (viti 859), e cila më vonë u bë një nga qendrat kryesuese shpirtërore dhe arsimore, në epokën e artë të botës islame. Universiteti filloi të jepte mësim menjëherë pas ndërtimit të xhamisë, në formën e mësimeve dhe seminareve të mbajtura në të, në-it, por disa historianë besojnë se kjo xhami u bë universitet pas epokës Murabite, ose Merinide. Universiteti El-Karavijjin, konsiderohet gjithashtu institucioni i parë shkencor në botë, që shpiku tribunat shkencore dhe gradat e specializuara shkencore.

Ky universitet u përfshi në sistemin universitar publik modern në Marok, në vitin 1382 të hixhretit (1963). Arkitektura dhe stili i xhamisë përfaqësojnë arkitekturën historike marokene dhe islame, e cila përfshin shumë zbukurime të ndryshme, që u përkasin periudhave të ndryshme të historisë së Magribit.[6]

Përgatiti:
Msc. Arta Ujkaj,
teologe

1. https://en.wikipedia.org/wiki/Morocco
2. https://www.worldometers.info/world-population/morocco-population/
3. https:// www.marefa.org
4. https:// www.marefa.org
5. https:// www.cia.gov/library/publications/the-world-factbook/geos/mo.html
6. https://ar.wikipedia.org

MYFTIU NGUSHËLLOI AMBASADORIN E KUVAJTIT PËR NDARJEN NGA JETA TË EMIRIT AL-SABAH

Sheik Sabah Al-Ahmed Al-Xhabir As-Sabah (r.h)

Ditën e enjte, më 1 tetor 2020, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, mori pjesë në pritjen zyrtare të ngushëllimeve dhe konsideratave, organizuar nga ambasada e Shtetit të Kuvajtit në vendin tonë, me rastin e ndërrimit jetë të Emirit të Kuvajtit, Sheik Sabah Al-Ahmed Al-Xhabir As-Sabah, i cili u nda nga jeta ditën e martë, më 29 shtator 2020, në moshën 91 vjeçare.

Me këtë rast, Myftiu Sytari i shprehu ngushëllimet e tij dhe Myftinisë Shkodër ambasadorit kuvajtian, ShTZ. Fajiz Meshari Al-Xhasim, duke shprehur respektin dhe nderimin e madh për Emirin e Kuvajtit, Madhërinë e Tij, Emirin Sabah Al-Sabah, i mirënjohur botërisht për qëndrimet e tij fisnike në përkrahje të njerëzve në nevojë, për qëndrimet dinjitoze rreth çështjes së Palestinës, për thirrjet e tij të urta drejt paqtimit dhe bashkëpunimit në mesin e vendeve në konflikt dhe përtej!

Myftiu i dorëzoi ambasadorit Al-Xhasim edhe një ngushëllim zyrtar në emër të Myftinisë Shkodër, imamëve dhe besimtarëve të saj, që luten për shpirtin e Emirit të Kuvajtit, që kaloi nga kjo botë, duke lënë pas gjurmë të shumta, që e rreshtojnë emrin e tij më mesin e njerëzve të shquar të shekullit.

Në këtë shprehje ngushëllimi, Myftiu shoqërohej edhe nga drejtori i Medresesë "Haxhi Sheh Shamia", z. Kujtim Dervishi, sekretari i Këshillit të Myftinisë Shkodër, H. Fejzi Zaganjori, imami i xhamisë Parrucë, teologu Naim Drijaj dhe sekretari organizativ i Myftinisë Shkodër, teologu Lavdrim Hamja.

NË XHAMINË E PARRUCËS FALET XHENAZJA NË MUNGESË PËR EMIRIN E KUVAJTIT

Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari gjatë hytbes së xhumasë, më 2 tetor 2020, në xhaminë e Parrucës vlerësoi lart personalitetin e lartë të Emirit të Kuvajtit, Shejkh Sabah Al-Ahmed Al-Xhabir Es-Sabah, i cili ndërroi jetë në moshën 91 vjeçare, të martën, më 29 shtator 2020.

Myftiu, edhe në emër të institucionit të Myftinisë dhe të gjithë myslimanëve të Shkodrës shprehu ngushëllimin zyrtar si dhe ftoj të gjithë besimtarët e pranishëm dhe më tej të luten për shpirtin e Emirit të Kuvajtit, i cili u nda nga kjo jetë duke lënë gjurmë të mëdha në humanizëm dhe solidaritetit me të gjitha vendet e botës pa dallim besimi, race, kombi dhe gjuhe.

Myftiu tha se: Emiri i Kuvajtit u nda me faqe të bardhë nga kjo botë e ngarkuar me fitne dhe sprova nga më të ndryshmet. Një njeri, i cili meritoi nga Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB) para pak vitesh vlerësimin e madh "Udhëheqësi i Humanizimit".

Gjurmët e humanizmit, sipas Imam Muhamed Sytarit, janë të pranishme edhe në vendin tonë, tash 30 vite investime pa kushte, në shumë fusha (ekonomike, sociale, kulturore) etj.

Edhe Shkodra ka pasur nderin dhe fatin e mirë që bamirësia dhe humanizimi i Shtetit të Kuvajtit nën udhëheqjen e Emirit të tij, të shtrihet përmes ndërtimit të shumë xhamive dhe qendrave kulturore, ndihmave për mijëra jetimë dhe familje në nevojë si dhe shumë investime sociale, të cilat duhet përherë të kenë nga ana e jonë mirënjohjen dhe falënderimin ndaj udhëheqjes së Kuvajtit dhe popullit të tij vëlla dhe mik të përhershëm.

Pas faljes së namazit të xhumasë, nën drejtimin e Myftiut të Shkodrës u fal xhenazja në mungesë si dhe u bënë lutje për shpirtin e Shejkh Sabah Al-Ahmed Al-Xhabir Es-Sabah.

MYFTIU: "KY ISLAM ËSHTË SHPRESA E KËTIJ SHEKULL!"

Ditën e shtunë, më 3 tetor 2020, pas namazit të akshamit në xhaminë e Anës së Malit, u zhvillua ligjërata e të shtunës, në kuadër të aktivitetit periodik: "Xhamia na mbledh, drita e All-llahut na udhëzon".

Ligjërata e kësaj mbrëmje u mbajt nga Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i cili hodhi dritë rreth temës së qëndrueshmërisë në fenë islame.

Ndër të tjera, Myftiu theksoi se: "Ky Islam është Dritë e pastër, që nuk njolloset nga askush në botë! Pra, sikur të mblidhen krejt djajt e botës për ta njollosur sadopak këtë Islam të pastër, nuk do ia arrijnë, të dashurit e mi!

Dikur ju thonin: 'Problemi i hixhabit', sot ju thonë: 'Islami në krizë!?', aty ju thonë: 'Karikaturat (e gjoja Profetit) janë liri e të shprehurit!?', këtu ju thonë: 'Laicizmi", etj.

Të gjitha këto propaganda së bashku, nuk arrijnë dot ta shuajnë këtë dritë të pastër, që përhapet ditë pas dite, gjithandej nëpër botë, për të dëshmuar gjithësecili prej nesh me sytë e zemrës e me sytë e ballit atë fjalë të madhe

të Pejgamberit (a.s) që thoshte: 'Do të mbërrijë kjo çështje (kjo fé), ku ka mbërritur nata dhe dita!'.

Kjo do të thotë se ky Islam dhe kjo Dritë e madhe është shpresa e këtij shekulli, është e mira e madhe e munguar e njerëzimit në këtë kohë dhe në këtë shekull, që do të thotë se ky shekull është shekulli i Islamit!

Prandaj, ti si musliman, a je gati për ta dëshmuar mirësinë e kësaj dëshmie të madhe të Pejgamberit (a.s), për të qenë përhapës i kësaj Drite?".

Aktiviteti i kësaj mbrëmje u përshëndet edhe nga teologu Ervil Kuçi, përgjegjës i sektorit të rinisë në Myftininë e Shkodrës.

MYFTIU: "TA JETOJMË JETËN ME VLERAT E KUR'ANIT!"

Ditën e shtunë, më 3 tetor 2020, pas namazit të jacisë, në xhaminë e Zuesit, Myftinia Shkodër vijoi me ciklin e ligjëratave: "Xhamia na mbledh, drita e All-llahut na udhëzon", ku ligjëroi Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari.

Në ligjëratën e kësaj mbrëmje, Myftiu u ndal tek haku i Kur'anit në jetën e muslimanëve dhe tek mirësia e madhe, me të cilën Zoti i gjithësisë e ka begatuar njerëzimin, teksa ka lajmëruar se Ai është Mbrojtësi i Kur'anit, që do të thotë se njerëzimi e kanë përherë një garanci të palëkundur në rrugën e udhëzimit.

Gjatë ligjëratës së tij, ndër të tjera Myftiu tha: "Ajo çfarë dua të ndaj sot me ju, të dashurit e mi, ka të bëjë me Kur'anin Famëlartë, këtë Libër, të cilin e kemi para duarve dhe, të cilin përpiqemi ta lexojmë e ta kuptojmë. Se, nuk do të them se e lexojmë dhe e kuptojmë, se po ta lexojmë e ta kuptojmë siç duhet Kur'anin, do të ishim shumë më mirë se ç'jemi në të vërtetë!

Në të vërtetë ne përpiqemi ta lexojmë e ta kuptojmë Kur'anin dhe, kjo është gjë shumë e mirë!

Ajo mirësi me të cilën na ka begatuar All-llahu i Madhëruar, duke na veçuar prej krejt ymeteve të tjera është se, ky Libër është i njëjti, siç është kënduar e lexuar në kohën e Hazreti Pejgamberit tonë (a.s)! Nuk duhet të ketë asnjë lloj

dyshimi, asnjëri prej nesh, në këtë mrekulli hyjnore, që përshkruhet shumë qartë në ajetin kur'anor: "Ne e kemi shpallur Përkujtuesin (Kur'anin) dhe Ne jemi mbrojtësit e tij!".

Vetë Zoti i gjithësisë e ka quajtur këtë Kur'an, Përkujtues, sepse në Kur'an përkujtohemi për të bërë më të mirën në jetë dhe për t'u distancuar nga çdo gjë e dëmshme dhe e pavlerë për jetën tonë!

All-llahu i Madhëruar e ka bërë këtë Kur'an gjithëpërfshirës! Brenda këtij Kur'ani lexojmë edhe thelbin dhe esencën e Inxhilit. Lexojmë edhe thelbin dhe esencën e Teuratit. Lexojmë edhe thelbin dhe esencën e Zeburit!

Është një fatmirësi shumë e madhe që e kemi këtë Kur'an në mesin tonë, të cilit duhet t'i përkushtohemi maksimalisht, në mënyrë që ta shtrojmë jetën tonë sipas udhëzimit të tij! Atë, çfarë All-llahu i Madhëruar na e kërkon ta bëjmë, ta bëjmë, pa pasur asnjë ndrojtje, mëdyshje a hezitim në të!

A ke dyshim në përzgjedhjen e Zotit tënd për ty?! Poashtu, atë çfarë e ka ndaluar në këtë Libër, me u përpjekë për t'u larguar dhe distancuar prej tij maksimalisht!

Ne duam ta lexojmë Kur'anin, ta kuptojmë atë dhe ta jetojmë jetën me vlerat e Kur'anit!".

MYFTIU FALËNDEROI IMAMËT PËR SHËRBIMET DHE PËRKUSHTIMIN

Pasditën e së mërkurës, më 7 tetor 2020, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, zhvilloi një takim pune me një grup imamësh të qytetit dhe të fshatit, në prag të Muajit Rebiulevvel 1442.

Në krye të herës, Myftiu shprehu falënderimet e tij për imamët e Myftinisë Shkodër, për krejt angazhimin e tyre dhe shërbimet në një periudhë tepër të çuditshme dhe të vështirë, si kjo që po kalojmë.

Më tej ai dha udhëzimet e tij në prag të Muajit Rebiulevvel 1442, duke vënë theksin tek detyrimet që kanë imamët dhe thirrësit islamë në hak të Resulullahut (a.s), sidomos në këtë kohë të ngarkuar nga propaganda dashakeqe kundër Islamit dhe muslimanëve.

Njëkohësisht u diskutua edhe për shumë tema që lidhen me shërbimet e xhamisë dhe angazhimet e imamëve në rrugëtimet e tyre në krye të xhemateve dhe interesave të Thirrjes Islame.

Myftiu ftoi imamët e nderuar drejt korrigjimit të asaj që është prishur nga gjurmët e traditave dhe tabanit dhe shfrytëzimin e kohës për të ecur përpara me besim, dinjitet e kurajo.

KUJTESË HISTORIKE

Si sot, më 17 Muharrem 855, i Lavdishmi Sulltan Mehmet Fatih, u kurorëzua për herë të dytë si Sulltan i Hilafetit Osman, pas vdekjes së Sulltan Muradit II, i cili hoqi dorë nga drejtimi i hilafetit dhe ia dorëzoi të birit, pas triumfit kundër hungarezëve në betejën e Varnas, në vitin 848 h.

Sulltan Mehmet Fatihu i dha goditjen përfundimtare Perandorisë Bizantine, pas një jetëgjatësie prej 11 shekujsh.

MYFTIU VIJON CIKLIN E HYTBEVE MBI MADHËSHTINË E HZ. MUHAMMEDIT (A.S)

Prej 6 javësh, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, vijon të ligjërojë nga minberi i xhamisë së Parrucës mbi madhështinë dhe pozitën e lartë të Hz. Muhammedit (a.s).

Ky cikël i ri i hytbeve të Myftiut nisi si reagim ndaj ripublikimit të ashtuquajturave karikatura, që prekin emrin e lartë të Hz. Muhammedit (a.s) në një revistë franceze dhe mbrojtjen e këtij veprimi racist dhe primitiv nga presidenti francez.

Në krye të herës, Myftiu theksoi se nxitja e urrejtjes ndaj Islamit dhe muslimanëve është shenjë e dekadencës morale dhe shpirtërore dhe se promovimi i kësaj fryme mesjetare, që prek shenjtëritë e feve dhe Islamit në veçanti, përkthen më së miri urrejtjen e rrënjosur në shpirtrat e humbur dhe nxitësit e së keqes në botë.

Myftiu tha se personaliteti i Hz. Muhammedit (a.s) është vijë e kuqe dhe se askush nuk duhet toleruar, kur bëhet

fjalë për më të madhin e njerëzimit, për të cilin flasin librat e shenjtë dhe të cilin e kanë vlerësuar intelektualët dhe kokat më të mëdha të botës.

Me këtë rast, Myftiu nisi edhe tefsirin e sures Ed-Duha, ku gjatë këtyre gjashtë javëve, hodhi dritë mbi detaje të mrekullueshme, rreth madhërimit që Zoti i gjithësisë i ka bërë të Dërguarit të Tij, Hz. Muhammedit (a.s).

Njëkohësisht, në mbledhjen e datës 7 tetor 2020, me imamë të qytetit dhe fshatit, udhëzoi që hytbet e xhumasë në të gjitha xhamitë e Shkodrës, duke nisur nga data 16 tetor 2020 dhe në harkun e krejt muajit Rebiulevel 1442, do të fokusohen tek tema: "Çfarë përfitoi bota me ardhjen e Hz. Muhammedit (a.s)".

MEJTEPI I IM... XHAMIA MES-MYSELIM

PAK HISTORI:

- Xhamia Mes-Myselim, ndodhet në njësinë administrative Postribë, zona Shkodër.

- Fshati Mes-Myselim përbëhet prej 430 familje myslimane (200 në Mes dhe 230 në Myselim). Fiset më të njohura në Mes janë: Uraj, Brahimaj, Çallataj, Kapllanaj, Alija, Bracaj etj. Ndërsa, fiset më të njohura në Myselim janë: Aliaj, Hysaj, Velilaj, Kallaj, Merturi, Çavoni, Gjonbibaj etj.

- Pas rilejimit të fesë, banorët e kësaj zone kanë kryer ritet fetare në xhaminë e vjetër, ndërsa në vitin 2010 me kontributin e vetë banorëve, të Myftinisë si dhe bamirësve të ndryshëm ka filluar ndërtimi i xhamisë së re, e cila ka përfunduar në vitin 2015.

- Pas rihapjes së kulteve fetare dhe lirisë fetare, nga viti 1991 e deri më sot kanë

shërbyer si imam dhe mësues feje: Musa Vila, Dashamir Shabaj, Agim Hoxha, Naim Drijaj, Bledar Xama, Altin Nikshiqi, Learta Fejza(mësuese) dhe Fatmir Sula (imami aktual).

- Numri i nxënësve që kanë frekuentuar rregullisht rreth 17 kurse të ndryshme fetare të mësim-besimit, të zhvilluar në xhami në periudha të ndryshme nga viti 2002 -2020 është rreth 560 nxënës dhe nxënëse.

TAKIMI ME NXËNËSIT:

Në kuadër të programit për zhvillimin e vizitave dhe takimeve me nxënësit e xhamive që frekuentojnë kurset-mejtepet e mësim-besimit, drejtuesi i arsimit, pranë Myftinisë Shkodër, teologu Arben Halluni organizoi takimin e radhës, pas xhumasë, më 02 tetor 2020 me nxënësit e kursit fetarë në xhaminë Mes-Myselimit.

Teologu Halluni u mbajti një bisedë, duke u përqendruar në rëndësinë dhe vlerën që ka organizimi i mejtepeve fetare pranë xhamive dhe për misionin që ato mbartin si përçimin te brezi i ri mësimet e vërteta fetare, edukatën islame që duhet të ketë çdo besimtar dhe frymën e mirë paqësore që duhet të karakterizojë çdo njeri në marrëdhëniet me të gjithë njerëzit dhe krijesat e Zotit.

Më pas, drejtuesi arsimit foli edhe për respektimin e rregullave gjatë procesit mësimor kundër përhapjes së koronavirusit/covid-19 si dhe evidentoi ecurinë mësimore të nxënësve, pjesëmarrjen e tyre, procesin mësimor nga mësuesi dhe imami Fatmir Sula.

MYFTIU PRITI KRYETARIN E KOMUNITETIT MYSLIMAN TË SHQIPËRISË, H. BUJAR SPAHIU

Paraditën e së xhumasë, më 23 tetor 2020, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, priti në një vizitë pune, Kryetarin e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu.

Gjatë takimit u diskutua rreth aktivitetit të Myftinisë Shkodër në prag të 30 vjetorit të përkujtimit të datës jubilare të rihapjes së xhamisë së parë në Shqipëri, në ditët e para të nëntorit 1990, që kulmoi me ceremoninë madhështore të 16 nëntorit 1990.

Myftiu theksoi se viti 2020 ishte i ngarkuar me vështirësi të mëdha, që ende vazhdojnë, që përkufizuan planin e përgatitur nga Myftinia Shkodër në fillim të këtij viti kalendarik dhe të miratuar më parë nga Këshilli i Myftinisë.

Më tej u diskutua për disa nga problematikat e brendshme, që lidhen me aktivitetin e xhamisë, shërbimet e imamëve, ruajtjen e traditave dhe mbi të gjitha, angazhimin e madh për ruajtjen e frymës së harmonisë dhe vëllazërisë islame.

Me rastin e kësaj vizite në Shkodër, Kryetari i KMSh-së mbajti edhe hytben e xhumasë në xhaminë e Parrucës.

PROGRAM I LARMISHËM ME ILAHI, RECITIME, LIGJËRATA DHE DUAJA E HATMES SHERIFE

Në kuadër të ditëve përkujtimore të 30 vjetorit të rihapjes së xhamisë së parë, në ditët e para të nëntorit 1990, si dhe me rastin e përkujtimit të Lindjes së Begatë të Më të Mirit të gjithësisë, Mëshirës së dhuruar, Hz. Muhammedit (a.s), ditën e mërkurë, më 28 tetor 2020, pas namazit të iqindisë, në xhaminë e Parrucës, Myftinia Shkodër zhvilloi me motrat besimtare një program të larmishëm me ilahi, recitime, ligjërata dhe duaja e Hatmes Sherife.

Teologet Ferzet Ndoja dhe Jetmira Plaku, në ligjëratat e të cilave u vu theksi te rëndësia e tubimeve që nxisin përkujtimin e emrit të madh të Resulullahut (a.s) dhe nevojën që ka sot njerëzimi për shembullin e tij, në këto realitete sfidash, me të cilat përballet raca njerëzore.

Ata theksuan se Zoti i gjithësisë e dërgoi Hz. Muhammedin (a.s) mëshirë për mbarë krijesat, që do të thotë se mesazhi i tij është universal dhe se muslimanët duhet ta kuptojnë drejtë këtë, duke rinovuar besën e dashnisë dhe përkatësisë së shenjtë me Resulullahun (a.s).

U lexuan hadithe të ndryshme që na lidhin me madhështinë e mesazhit islam, si dhe u komentuan disa prej fjalëve të arta të Pejgamberit tonë (a.s), që mbeten busulla udhëzimi për të gjithë, deri në ditën e fundit.

PËR TË MOS HARRUAR DATAT TONA TË SHËNUARA!

(25 VJET XHAMIA E RE E FUSHË ÇELËS, "EBU BEKËR")

Më 27 tetor 1995, në qytetin e Shkodrës, u inaugurua Xhamia e re e Fushë Çelës, që u zbukurua me emrin e sahabiut të dashur, Hz. Ebu Bekër (All-llahu qoftë i kënaqur prej tij).

Xhamia u ringrit mbi vakëfin e vjetër, dhuruar dekada më parë nga i nderuari Çelë Zylyftari, rahmet pastë.

Xhamia aktuale është kontribut i familjes saudite Ez-Zamil, All-llahu i shpërbleftë me mirësitë dhe bekimet e Tij.

Disa prej imamëve, vaizëve dhe hatibëve që kanë shërbyer dhe vazhdojnë të kontribuojnë për këtë xhami të re, nga dita e inaugurimit dhe deri më sot, në përvjetorin e saj të 25-të:

H. Faik Hoxha (rahmet pastë), Mr. Muhidin Ahmeti (rahmet pastë), Hfz. Etem Haliti, teologu Sokol Mandi, teologu Ylli Buraniqi, Imam Ndriçim Sulejmani, teologu Idmir Plaku, teologu Gilman Kazazi, teologu Altin Nikshiqi, etj.

Mirënjohje dhe respekt për imamët tanë të nderuar, besimtarët frekuentues dhe kontribuuesit për mirëmbajtjen dhe gjallërimin e kësaj xhamie, pjesë e pandarë e pasaportës dhe identitetit të qytetit tonë!

"ÇFARË FITOI BOTA ME ARDHJEN (DËRGESËN) E HZ. MUHAMMEDIT (A.S)"

Cikël ligjëratash në kuadër të muajit Rebiulevel 1442

(Çdo ditë në orën: 17.00, në Facebook nga profili zyrtar i Myftinisë Shkodër: 28 tetor - 6 nëntor 2020)

DATA	LIGJËRUESI	TEMA
E Mërkurë 28.10.2020	H. Durim Kasemi	Domosdoshmëria e leximit të jetës së Pejgamberit (a.s)
E Enjte 29.10.2020	H. Idmir Plaku	Muhammedi (a.s), dëshmitar i tërë njerëzimit
E Xhuma 30.10.2020	H. Naim Drijaj	Vlera e salavatit dhe dobitë e tij
E Shtunë 31.10.2020	H. Gilman Kazazi	Morali i Hz. Muhammedit (a.s)
E Diel 1.11.2020	H. Adil Cukali	Trashëgimia e Pejgamberit (a.s) për ymetin e tij
E Hënë 2.11.2020	H. Ruzhdi Plangaj	"Dhe Ne ta ngritëm lart famën tënde"
E Martë 3.11.2020	H. Ervil Kuçi	Pejgamberi (a.s) shembulli më i mirë për njerëzimin
E Mërkurë 4.11.2020	H. Adem Pizga	Dashuria ndaj Pejgamberit (a.s)
E Enjte 5.11.2020	H. Fejzi Zaganjori	Mesazhe nga Dërgesa e Hz. Pejgamberit (a.s)
E Xhuma 6.11.2020	H. Lavdrim Hamja	Përgëzimet e Librave të mëparshëm për ardhjen e Pejgamberit (a.s)

DR. SALAHUDIN KEFTARO: "SHUMË MUSLIMANË KANË LËNË PAS DORE KUPTIMIN E THELLË TË FESË!"

Paraditën e së shtunës, më 31 tetor 2020, u zhvillua takimi i gjashtë i trajnimit 10 javor me imamët e Myftinisë Shkodër.

I ftuar special në këtë tryezë të veçantë elitare, ishte mendimtari islam damasken, Dr. Salahudin Ahmed Keftaro.

Në ligjërimin e tij, Dr. Keftaro iu drejtua imamëve të pranishëm me disa këshilla dhe udhëzime bashkëkohore, që burojnë nga urtësia e Shkollës së Kryemyftiut rahmetli të Sirisë, H.T. Shejkh Ahmed Keftaro.

Ndër të tjera, ai theksoi se: "Shumë muslimanë kanë lënë pas dore kuptimin e thellë të fesë dhe janë kapur pas shfaqjes së jashtme të adhurimeve, dhe kjo nuk është esenca dhe thelbi i fesë!".

Njëkohësisht, duke trajtuar zhvillimet e fundit pas deklaratave islamofobe në Francë, ai theksoi se: "Ne si muslimanë i duam të mirën njerëzimit dhe duam që atdheu ynë, kudo qofshim, të lulëzojë, përtej diversitetit të shoqërisë!".

Takimi u shoqërua edhe me ndërhyrjet e teologut Arben Halluni dhe imamit të nderuar, H. Fejzi Zaganjori, që u lutën edhe paqen në Siri dhe zgjimin e botës islame drejt vlerave të baahkimit dhe harmonisë.

Në fjalën e rastit, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, falënderoi mikun e madh, Dr. Salahudin Keftaro, sikurse theksoi se imamët sot, kanë një përgjegjësi të madhe për të dalë nga bota e detajeve përçarëse drejt thirrjes me urtësi dhe zgjimin e shoqërisë nga prag humnerat, ku e kanë çuar politikat e gabuara, që ndezin zjarre të urrejtjes, racizmit e islamofobisë në botë.

NJË SHPIKJE E PRESIDENTIT MAKRON: "ISLAMI FRANCEZ"

SHABAN MURATI

Presidenti francez Makron në 2 tetor 2020 mbajti një fjalim, ku siç njofton gazeta prestigjioze amerikane "Njujork Tajms" e 2 tetorit, shpalli planet për të zhvilluar një "Islam të Francës". Presidenti Makron brenda dy muajsh do të paraqesë dhe një ligj për këtë qëllim, sepse siç shkruan revista e madhe amerikane "Njuzuik": "Makron don të krijojë "Islamin francez"". Në fjalën e tij në 2 tetor presidenti francez nuk bëri të ditur nëse ai përveç "Islamit francez", ka plane për të zhvilluar edhe katolicizmin francez, protestantizmin francez, ortodoksizmin francez, judaizmin francez, etj.

Klasifikimi i fesë sipas emrave të shteteve qysh në pamjen e parë është idiotizëm, por përtej kësaj zbulon qëllimin e vërtetë të atyre udhëheqësve, kur shpallin se do të shtetëzojnë dhe do t'i venë emrin e shtetit vetëm një feje, asaj për të cilën kanë fobi.

Emërtimi i fesë sipas emrave të shtetit është një idiotizëm, të cilin e kanë shumë qejf edhe levantinët në Shqipëri dhe në Kosovë, që pretendojnë broçkullën " Islam shqiptar". Nuk flasin dhe nuk pretendojnë kurrë për katolicizëm shqiptar, për ortodoksizëm shqiptar, për protestantizëm shqiptar, për judaizëm shqiptar, etj. Islamofobia u dikton levantinëve shqiptarë klasifikimin me emrin e shtetit vetëm për fenë Islame. Le të presin sa ta krijojë presidenti Makron modelin e "Islamit francez" dhe ta kopjojnë prej tij, që të bëhen tamam levantinë.

E VËRTETA LAKURIQ

PARID TURDIU

Më çuan linkun e një seriali dokumentar te Fevziut për Shkodrën, shumë interesant.

Qyteti i sotëm është i ri, 200 vjeçar. Qyteti i vjetër ka qene rreth Kalasë, pastaj është zgjeruar duke filluar nga kalaja.

50 vjet me parë, që e mbaj mend unë Shkodrën, Pazari i Vjetër ishte në këmbë, por gjysëm i rrënuar, si një qytet fantazëm, kolosal (2 mijë dyqane). U prish nga tërmeti i 1905 dhe nuk u rindërtua. Në kodrën pas kalasë ishte një lagje e madhe sa Mangalemi i Beratit, e banuar krejt me magjypë. Duhej të kishte qenë qyteti mesjetar, i boshatisur kur ikën venecianët, i mbushur nga osmanë me magjypë që punonin për ushtrinë...

Pashë në dokumentar se nga ajo lagje kanë ngelur vetëm rrënoja. Aty duhen bërë gërmime, si dhe në kala, për të zbuluar qytetin e lashtë.

Para 50 vjetësh, autobusi kalonte urën e Baçallëkut mbi Drin, pastaj linte kalanë djathtas, pastaj urën e Bunës majtas, pastaj Pazarin e Vjetër djathtas dhe futej në lagjet myslimane. Shtëpia e gjyshes time ishte majtas rrugës kryesore, në lagjen Tophanë, - një shtëpi e madhe prej guri, me oborre e bahçe kolosale. Të gjitha shtëpitë ishin ashtu, me mure të larta dhe porta të mëdha. Rruga e ngushtë para portës se oborrit ishte me kalldrëm, me vijë uji anash dhe çonte në Zdralej, një shesh i vogël rrethuar me dyqane shumë të vjetra, ku degëzoheshin rrugë për në lagjet e thella myslimane, deri te liqeni. Pastaj ishte xhamija e Parrucës, prefektura, gjimnazi, Piaca dhe lulishtja. "Piacë" quhej bulevardi, sot Pedonalja.

Në fund të Piacës ishin "Dugajt e Reja" (pazari i ri). Këndej rrugës dyqanet ishin më të vjetra, osmanoide. Matanë ishin më europiane, duke përfshirë Kafen e Madhe.

Matanë Piacës ishin lagjet katolike.

Në dokumentar sikur kishin turp të përmendin trashëgiminë myslimane të Shkodrës.

Treguan vetëm shtëpinë e Oso Kukës, sot muze, që u përmend si shtëpi e "borgjezisë së vogël myslimane". Është një vilë e madhe, mansion.

"Myslimane ishte kjo?, - u habit Fevziu.

"Po, myslimane" - tha drejtoresha nëpër dhëmbë.

Unë: Po shtëpitë e borgjezisë së lartë? Po shtëpinë e feudaleve? Po xhamitë, medresetë, teqet, tyrbet?

Unë mbaj mend që të gjitha shtëpitë myslimane ishin të mëdha. Më vonë mehallat e vjetra u denatyruan me ndërtesat e varfra të Enverit. Shtëpinë e gjyshes sime e shembën me 1983, ku ndërtuan shkollën Ndre Mjeda (në Tophanë!) Të paktën të quhej "Motrat Pipa".

Muzeun e Kujtesës e kishin bërë bukur, te ish Dega e Brendshme. Qelitë ku janë burgosur e torturuar njerëzit tanë ishin ruajtur. Të gjithë meshkujt e familjes së nënës time, si dhe një teze e imja kanë qenë në ato qeli. Në mure ishin fotot e priftave të martirizuar. Qelitë e At Zef Pllumit dhe martires Marie Tuci i kishin zbukuruar me foto e kryqe, ndonëse qelitë nuk janë personale, të vetëm dy njerëzve.

Po njerëzit tanë?!

Pse akoma ekziston një "turp" për të hulumtuar periudhën myslimane të historisë së Shqipërisë?

Pse dokumentari kapërcen, nga venecianet me 1400, te Kisha e Madhe e ndërtuar nga austriakët me 1900, te italiani Marubi dhe arkitekti freng Briol (me duket se quhej ashtu), te rruga që i atribuohet gabimisht Idromenos (rruga ishte aty para tij), te 13 konsullatat e huaja - vatra intrigash, ndërsa vazhdon të injorohet pjesa më e madhe dhe më e vjetër e popullsisë së qytetit?

Shejkh Muhamed El-Gazali

"Ata duan me çdo mënyrë ta heqin qafe ISLAMIN, por deri më sot kanë dështuar... Myslimanët nuk e kanë harruar fenë e tyre, me gjithë harresat e shumta dhe as nuk është dobësuar nostalgjia e tyre për të jetuar nën hijen e tij, me tërë atë që ka bërë pushtimi kulturor, pas pushtimit ushtarak..!"

I DËRGUARI I ALL-LLAHUT, HZ. MUHAMMEDI (A.S)

MËSHIRË PËR MBARË BOTËT!

PËRKUJTIMI I LINDJES SË BEGATË TË PEJGAMBERIT (A.S)

(29 TETOR 2020 - 12 REBIUL-EVVEL 1442)

"ATY, KU TË PUNOSH PËR LARTËSIMIN E VLERAVE TË BESIMIT,

ATY E KE DËSHMUAR LIDHJEN TËNDE

ME TË DËRGUARIN E ALL-LLAHUT, MUHAMMEDIN (A.S)!"



Shejkh Ahmed Keftaro (1915 - 2004)

Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

MYFTINIASHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org

Çmimi: 50 lek